

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Zgjedhjet në Bosnje nën vëzhgimin e figurave të afërta me Kremlinin
ADRESA	https://www.cna.al/kosova-bota/zgjedhjet-ne-bosnje-nen-vezhgimin-e-figurave-te-aferta-me-kremlinin-i475289
BURIMI	cna.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 19:19:58 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 19:17:38 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	fc0bb142e068b4a3502f12598417e0ebec9e49fd60fd3e094be312604759f960
TEKSTI	208f670b68da0c0782cab9beeae8c5a4ac25dc012663dc60b151556e4c0fe40f
PAMJA	80851055f0feac2a38d07c2b419583fd103ba1b6127f671393f1472c84b28abf

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	716ecc8ece365659cec6c00b0aebc34843ec09c2e6fa205de4227cd034e091ca
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	bdb0f4977024bde548b4e3b2f30b00cf48adba46ab69ac7a79901c9e1751e8c0
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/716ecc8ece365659cec6c00b0aebc34843ec09c2e6fa205de4227cd034e091ca>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)



English
English

Zgjedhjet në Bosnje nën vëzhgimin e figurave të afërta me Kremlinin



26 Shtator 2026, 21:17, Kosova & Bota CNA



Një senatore nën sanksionet e Perëndimit dhe një ish-oficer i shërbimit të inteligjencës ushtarake, GRU, do të jenë në mesin e vëzhguesve rusë në zgjedhjet e përgjithshme në Bosnje dhe Hercegovinë, të caktuara për 4 tetor, mëson Radio Evropa e Lirë.

Bëhet fjalë për Elena Afanasevën, senatore nga rajoni i Orenburgut, e cila është sanksionuar nga Bashkimi Evropian, Shtetet e Bashkuara dhe Britania e Madhe, pasi mbështeti njohjen nga Rusia të territoreve separatiste në Ukrainë.

Për zgjedhjet në Bosnje dhe Hercegovinë do të udhëtojë edhe Aleksej Kondratjev, i cili, sipas një hulumtimi të mëhershëm të Radios Evropa e Lirë, lidhet edhe me Redutin - një organizatë private ushtarake ruse, që përfshin së paku 20 formacione të ndryshme të armatosura dhe që është e lidhur ngushtë me GRU-në.

Të dy janë në mesin e pesë personave të propozuar për vëzhgimin e zgjedhjeve nga Këshilli i Federatës Ruse - Dhoma e Lartë e Parlamentit rus - i kryesuar nga Valentina Matvienko.

Ajo ndodhet, po ashtu, nën sanksione amerikane dhe evropiane që nga viti 2014, për shkak të mbështetjes së politikës ruse ndaj Ukrainës.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i Bosnje dhe Hercegovinës miratoi gjithsej 20 vëzhgues rusë për zgjedhjet e caktuara për tetor, prej të cilëve 15 janë akredituar me kërkesë të Ambasadës së Rusisë në Bosnje dhe Hercegovinë.

Pesë vëzhgues të tjerë janë propozuar nga Këshilli i Federatës Ruse.

Përveç Afanasevës dhe Kondratjevit, në mesin e tyre janë edhe Vasilij Popov, Ana Kocherova dhe Vladimir Morozov.

Pjesëmarrja e përfaqësuesve të aparatit politik dhe të sigurisë së Rusisë në vëzhgimin e zgjedhjeve në Bosnje dhe Hercegovinë vjen në një kohë kur institucionet amerikane dhe evropiane paralajmërojnë për aktivitete të Rusisë në Ballkanin Perëndimor.

Për ndikimin rus në rajon u diskutua së voni edhe gjatë një seance dëgjimore në Kongresin amerikan, ndërsa OSBE-ja paralajmëroi se gjatë vëzhgimit të zgjedhjeve në Bosnje dhe Hercegovinë do t'i kushtoi vëmendje edhe ndërhyrjes së mundshme të huai dhe dezinformimit.

Ish-anëtari i KQZ-së dhe anëtari i organizatës "Pod lupom", e cila monitoron zgjedhjet në Bosnje dhe Hercegovinë, Vehid Shehiq, thotë se kërkesa e Rusisë për dërgimin e vëzhguesve në zgjedhje, është pjesë e procedurave të zakonshme, por se përbërja e delegacionit rus të këtij viti është e pazakontë.

“Natyrisht, nuk mund të pohojmë asgjë pa asnjë rezervë, por fakt është se përzgjedhja është e pazakontë”, thotë Shehiq për Radion Evropa e Lirë.

Elena Vladimirovna Afanaseva ndodhet nën sanksionet e Bashkimit Evropian që nga marsi i vitit 2022.

Ajo u sanksionua pasi, si anëtare e Këshillit të Federatës, votoi për ratifikimin e marrëveshjeve të Rusisë me të vetëshpallurat Republikë Popullore e Donjeckut dhe Republikë Popullore e Luhanskut.

Sipas arsyetimit të BE-së, bëhej fjalë për vendime që cenonin integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës.

Për të njëjtën arsye, ndaj saj u vendosën sanksione edhe në Britaninë e Madhe, ndërsa në shtator të vitit 2022, Departamenti amerikan i Thesarit e përfshiu në listën e personave të sanksionuar.

Viteve të fundit, Afanaseva ishte e përfshirë edhe në kontaktet e Rusisë me zyrtarë të Serbisë dhe të entitetit të Bosnje dhe Hercegovinës, Republika Srpska.

Disa muaj para zgjedhjeve në Bosnje dhe Hercegovinë, ajo mori pjesë edhe në një tryezë të rumbullakët në Moskë me deputetë të Kuvendit Popullor të Republikës Srpska, nga partitë në pushtet dhe opozitë.

Sipas raportimeve ruse për takimin, u diskutua për luftën e shkuar në Bosnje dhe Hercegovinë, “krimet kundër serbëve”, si dhe për rezultatet dhe pasojat e Marrëveshjes së Dejtonit.

Takimi në Moskë është një nga shembujt që dëshmojnë për marrëdhëniet e afërta politike të zyrtarëve të entitetit të Republikës Srpska me Moskën, të cilat kanë vazhduar edhe gjatë pushtimit rus të Ukrainës.

Megjithatë Bosnje dhe Hercegovina formalisht i është bashkuar shumicës së sanksioneve që BE-ja ka vendosur ndaj Rusisë, ato nuk janë zbatuar asnjëherë, për shkak të kundërshtimit të politikanëve nga Republika Srpska në institucionet shtetërore.

Në mesin e vëzhguesve të zgjedhjeve në tetor pritet të jetë edhe Aleksej Kondratjev, senator rus që aktualisht përfaqëson rajonin e Tambovit dhe është anëtar i Komitetit për Çështje Ndërkombëtare të Këshillit të Federatës.

Sipas biografisë së tij të publikuar, Kondratjev ka shërbyer nga viti 1998 deri më 2010 në njësitë e forcave speciale të GRU-së - shërbimit rus të inteligjencës ushtarake.

Ai ka qenë zëvendëskomandant i Brigadës së 16-të të Veçantë të Forcave Speciale të GRU-së dhe ka arritur gradën e kolonelit.

Ka marrë pjesë në luftërat në Çeçeni dhe në operacionin paqeruajtës rus në Kosovë.

Sipas një hulumtimi të Shërbimit rus dhe atij ukrainas të Radios Evropa e Lirë, pasi Rusia ka nisur pushtimin e Ukrainës në shkurt të vitit 2022, Kondratjev i është rikthyer karrierës ushtarake dhe ka marrë komandën e brigadës vullnetare kozake Don.

Në vitin 2023, kjo brigadë është bërë pjesë e të ashtuquajturit Korpus Vullnetar i Ministrisë ruse të Mbrojtjes, së bashku me formacione të tjera që më herët kanë vepruar përmes rrjetit Redut.

Një hulumtim i Radios Evropa e Lirë, i publikuar në tetor të vitit 2023, konstatoi se GRU-ja kishte rol kyç në krijimin dhe funksionimin e Redutit - një rrjet që përfshin së paku 20 formacione të ndryshme të armatosura dhe shërben për rekrutimin e njerëzve për luftën në Ukrainë.

Sipas këtij hulumtimi, në mesin e personave që drejtonin sistemin Redut, ishte edhe Kondratjev, së bashku me zëvendëshefin e GRU-së, Vladimir Aleksejev, dhe kolonelin e Shtabit të Përgjithshëm, Sergej Drozdov.

Në shkurt të vitit 2023, Kondratjev mori pjesë edhe në kongresin e Unionit të Vullnetarëve të Donbasit në Mariupolin e pushtuar, në Ukrainë, ku u paralajmërua formimi i Korpusit Vullnetar.

Në fotografitë nga kjo ngjarje, hulumtuesit e identifikuan atë së bashku me Vladimir Aleksejevin, zëvendëshefin e GRU-së.

Përveç Afanasevës dhe Kondratjevit, në mesin e kandidatëve të propozuar nga Këshilli i Federatës është edhe senatorja nga rajoni i Belgorodit, Anna Kocherova.

Para se të bëhej pjesë e Këshillit të Federatës, ajo drejtonte degën rajonale të fondit shtetëror “Mbrojtësit e Atdheut”, i cili ndihmon ushtarët rusë dhe familjet e tyre.

Ajo hyri në Këshillin e Federatës vitin e kaluar, pasi u zgjodh në Dumën rajonale të Belgorodit nga lista e Rusisë së Bashkuar - partisë së presidentit rus, Vladimir Putin.

Sa u përket Vasilij Popovit dhe Vladimir Morozovit, të cilët po ashtu janë në listën e Këshillit të Federatës Ruse dhe janë miratuar nga KQZ-ja e Bosnje dhe Hercegovinës për vëzhgimin e zgjedhjeve, Radio Evropa e Lirë nuk arriti të përcaktonte se çfarë funksionesh mbajnë.

Zgjedhjet në Bosnje dhe Hercegovinë pritet të monitorohen nga rreth 730 vëzhgues, të cilëve Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ua miraton akreditimet.

Në mesin e tyre janë edhe vëzhgues të OSBE/ODIHR-it dhe të Asamblesë Parlamentare të OSBE-së.

I pyetur për vëzhguesit rusë dhe misionet vëzhguese me lidhje politike, një përfaqësues i Asamblesë Parlamentare të OSBE-së nuk dëshoi të komentonte raste të veçanta.

Ai tha për Radion Evropa e Lirë se secili mision ka karakteristikat e veta dhe se Asambleja Parlamentare e OSBE-së nuk ka një qëndrim të vetëm për të gjitha nismat e tilla.

Megjithatë, ai theksoi se OSBE-ja zbaton të njëjtën metodologji në të gjitha vendet, bazuar në standardet e dakorduara nga shtetet anëtare të organizatës, dhe se qëndrueshmëria, transparencja dhe paanshmëria janë elemente kyç të një vëzhgimi të besueshëm ndërkombëtar të zgjedhjeve.

“Është e rëndësishme që metodologjia e përdorur nga misionet vëzhguese të analizohet në mënyrë të pavarur dhe të kujdesshme dhe, mbi këtë bazë, të vlerësohet legjitimiteti i tyre”, tha ai.

Radio Evropa e Lirë dërgoi pyetje për rolin e vëzhguesve rusë në Bosnje dhe Hercegovinë edhe te Bashkimi Evropian dhe Departamenti amerikan i Shtetit, por, deri në publikimin e këtij artikulli, nuk mori përgjigje.

OSBE-ja nuk është ftuar për t'i vëzhguar zgjedhjet parlamentare të këtij viti në Rusi.

Organizata e ka cilësuar këtë si pjesë të një modeli më të gjerë të shpërfilljes së transparencës, llogaridhënies demokratike dhe sundimit të ligjit.

Ndërsa vëzhguesit rusë do t'i monitorojnë zgjedhjet e përgjithshme në Bosnje dhe Hercegovinë, në zgjedhjet e këtij viti për Dumën Shtetërore të Federatës Ruse morën pjesë një numër i madh vëzhguesish ndërkombëtarë, mes tyre edhe përfaqësues nga Bosnje dhe Hercegovina dhe Serbia.

Një medium rus nga rajoni i Tomskut raportoi se tetë ekspertë të huaj nga Bosnje dhe Hercegovina, Kamboxhia, Kenia, Serbia dhe Uzbekistani monitoruan zgjedhjet për Dumën Shtetërore dhe për parlamentin rajonal të Tomskut.

Një nga vëzhguesit nga Bosnje dhe Hercegovina ishte Danijell Simiq, gazetar i Radio-Televizionit të Republikës Srpska.

Pas përfundimit të votimit në rajonin e Tomskut, Simiq publikoi një koment në rrjetin social X, në të cilin i përshkroi pozitivisht zgjedhjet ruse, ndërsa Rusinë e quajti “fener të arsyes”.

Milan Damnjanović, anëtar i Partisë Fshatare Serbe, ishte vëzhgues ndërkombëtar në zgjedhjet ruse në shtator të vitit 2026 dhe, sipas një videoje që e siguroi Radio Evropa e Lirë, ai i monitoroi zgjedhjet në territoret e pushtuara të Ukrainës.

Damnjanović aty prezantohet si vëzhgues ndërkombëtar në Mariupol dhe thotë se do të monitorojë nëse zgjedhjet zhvillohen në rregull.

Vehid Shehiq, përfaqësues i organizatës “Pod lupom”, e cila monitoron zgjedhjet në Bosnje dhe Hercegovinë, thotë për Radion Evropa e Lirë se nuk e befason shkuarja e vëzhguesve nga Serbia dhe Bosnje dhe Hercegovina në territoret e pushtuara të Ukrainës.

“Nëse vullnetarët kanë shkuar në luftë, dhe kani raport se kanë shkuar dhe kanë qenë në komandën e ushtrisë ruse, atëherë mund të shkojnë edhe

kye vëmendje në raportet e tyre, dhe këtu raportet se kanë shkuar dhe kanë qenë nën komandën e ushtrisë ruse, dhe në mënyrë të shprehur kanë vëzhguesit. Fatkeqësisht, po jetojmë në një 'normalitet të ri', thotë ai.

Sipas të dhënave të siguruara nga Radio Evropa e Lirë, këtë vit në mesin e pjesëmarrësve serbë në misionin rus të vëzhgimit ishte edhe Aleksandar Vulin, ish-shef i Agjencisë së Sigurisë dhe Informacionit të Serbisë (BIA), i cili ndodhet nën sanksionet e SHBA-së, pikërisht për shkak të lidhjeve me Moskën.


Në mesin e vëzhguesve serbë të zgjedhjeve ruse ishin përfaqësues të Partisë Përparimtare Serbe të presidentit Aleksandar Vuçiq, Lëvizjes së Socialistëve të Aleksandar Vulinit, Partisë Popullore Serbe, lëvizjes "Ne - Zëri i Popullit" dhe shoqatës "Fronti Serbo-Rus".

Përveç tyre, disa ditë pas zgjedhjeve parlamentare ruse, nënkryetari i Komisionit Republikan të Zgjedhjeve të Serbisë, Marko Janković, të cilin agjencia ruse TASS e prezantoi edhe si vëzhgues ndërkombëtar të zgjedhjeve, mori pjesë në Moskë në një forum të organizuar nga organizata ruse ANO Dialog Regions.

Kjo organizatë është sanksionuar nga Shtetet e Bashkuara për shkak të lidhjeve me operacionet ruse të ndikimit dhe dezinformimit, ndërsa BE-ja e sanksionoi në vitin 2026 drejtorin e saj, Vladimir Tabak.

Serbia pritet të mbajë zgjedhje të parakohshme parlamentare në fund të tetorit, ndërsa informacionet për misionet ndërkombëtare të vëzhgimit nuk janë publikuar ende.

Në ciklet e mëparshme zgjedhore, në mesin e vëzhguesve kishte edhe zyrtarë rusë, të cilët e vlerësuan pozitivisht procesin e votimit, ndërsa misionet ndërkombëtare të udhëhequra nga OSBE/ODIHR-i, në raportet e tyre, evidentuan probleme gjatë procesit zgjedhor./Rel





Kush ishte Zai Fundo?

Të sugjeruara

Trump refuzon planin iranian për rihapjen e Ngushticës së Hormuzit

Shpërthimi në Athinë/ Rritet bilanci i viktimave, 6 persona humbin jetën

Italia ndalon burkat në shkolla

Partitë ekstremiste po lulëzojnë dhe kjo i tremb njerëzit

Irani i propozon marrëveshje SHBA-së për të rihapur Ngushticën e Hormuzit brenda shtatë ditësh

Kishte destinacion Kosovën/ Mali i Zi ndalon ngarkesën me mish të skaduar

U qëllua me armë gjatë një tubimi të Trump në Pensilvani/ 76-vjeçari humb jetën pas dy vitesh

Bundestagu gjerman miraton zbritjen e taksës së karburantit

Në disa qytete të Kosovës protestohet kundër dënimit të ish-krerëve të UÇK-së

Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së/ Nisma për ndryshimin e ligjit të "Speciales" dërgohet për mendim në Qeveri

Takimi Trump-Xi: Fanfara, paradë, bankete dhe pak rezultate

Greqia po përpiqet të rikthejë punëtorët e kualifikuar

Ekonomia gjermane po rimëkëmbet, por për sa kohë?

Dyshohet për krime në kampin nazist të të burgosurve të luftës/ Nisin hetimet ndaj 105-vjeçarit në Gjermani

FOTO/ Dhjetëra delegatë braktisin sallën e OKB-së sapo Netanyahu merr fjalën

I shiti Pentagonit softuer për hakimin e telefonave/ Kompania rezulton me pronësi ruse

Rekord i ri për vitin 2026/ Ja sa emigrantë kanë kaluar brenda një dite Kanalin Anglez

Rikthimi i Turqisë në programin F-35/ Erdogan: Trump është pozitiv për këtë perspektivë

Takim Trump-Putin në dhjetor?/ Reagon Kremlini, ja çfarë mund të ndodhë


Pas bisedimeve me SHBA-në/ Lukashenko liron 15 të burgosur politikë

[editorial](#)

09:11 Editorial Bujar Leskaj

Të ndihmojmë SHISH-in të mbrojë shtetin nga krimi, dhe jo krimin nga shteti!!

CNA LIVESTREAM



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.